

VENDIM
Nr. 40, datë 10.3.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “LAJTHIZA INVEST” SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “QAMI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin shtesë në vijim të relacionit nr. 322/3 prot., datë 28.2.2022, me nr. 322/3-1 prot., datë 8.3.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’, me kapacitet të instaluar 1.730 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 11, datë 21.1.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, në përroin e Srriqes, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqes, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës.

- ERE, me shkresën nr. 70/2 prot., datë 21.1.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e treta (datë 4.2.2022), nuk rezultoi të ketë pasur të tilla.

- Me shkresat e protokolluara në ERE, me nr. 11/3 prot., datë 2.2.2022, nr. 11/5 prot., datë 17.2.2022 dhe nr. 11/6 prot., datë 25.2.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar në mbështetje të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Bordi i ERE-s, me miratimin e vendimit nr. 36, datë 3.3.2022, vendosi të zgjasë vendimarrjen për të sqaruar me shoqërinë një pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi.

- ERE njoftoi shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a. për këtë vendimarrje me *email*, më datë 7.3.2022, protokolluar me nr. 11/7 prot., shoqëria ktheu përgjigje me *email* më datë 7.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 1/8 prot.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Lajthiza Invest” sh.a. rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”. Plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”. Plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”. Plotësuar.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik. Neni 9, pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”. Plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar.

Në lidhje me dokumentacionin sa më poshtë:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2.

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik).

Shoqëria ka depozituar në ERE strukturën e funksionimit të saj, së bashku me listën emërore të personelit sipas departamenteve përkatëse, pjesë e së cilës është dhe një inxhinier elektrik. Shoqëria ka depozituar po ashtu deklaratën e përgjegjësisë profesionale dhe licencën e hartuesit të projektit elektrik të HEC “Qami 1”. Në kuptim të nenit 16, pika 1, të VKM-së nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e ndryshuar, përcaktohet se licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të tij të ushtrojë veprimtari të caktuar profesionale sipas kategorive të punimeve të fituara në studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim duke u mbështetur në kushtet e kriteret përkatëse. Po ashtu në lidhjen 2, pika 10, të kësaj VKM-je te kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim, përfshihet projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë.

Për sa depozituar nga shoqëria, por duke marrë në konsideratë dhe faktin që nga shoqëria “Lajthiza Invest” sh.a., është deklaruar se ka përfunduar ndërtimi i veprës, vlerësohet se shoqëria e ka plotësuar këtë kërkesë të rregullores.

- germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme etj.).

Shoqëria ka përcjellë në ERE dhe kontratën nr. 9992 rep., nr. 4043 rep., datë 5.7.2021, të nënshkruar me një person fizik në cilësinë e qiradhënësit për territorin pronë private, e cila është e vlefshme deri më 1.1.2066, ndërsa kontratatë të qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a. u ka kaluar afati i vlefshmërisë. Përkatësisht kontrata e lidhur me Bashkinë Fushë-Arrëz nr. 1653 prot., datë 7.7.2017 (me afat dyvjeçar) dhe nr. 4054 prot., datë 4.12.2018 (me afat njëvjeçar), si dhe me Bashkinë Kukës nr. 62 prot., datë 4.8.2017 me afat dyvjeçar) dhe nr. 75 prot., datë 12.12.2018 (me afat dyvjeçar). Shoqëria ka depozituar dhe aplikimin përkatës për regjistrimin e kontratatë të qirasë me Bashkinë Fushë-Arrëz, drejtuar ZVRPP Pukë, si dhe shkresën drejtuar ZVRPP Pukë, datë 24.2.2022, për regjistrimin e kontratës koncesionare me MIE-n nr. 2856 rep., dhe nr. 1350/1 kol. Për sa depozituar dhe duke qenë se shoqëria nuk e ka plotësuar tërësisht këtë kërkesë të rregullores, vlerësohet që t’i lihet kusht që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi të depozitohet në ERE kontratat e rinovuara të qirasë për gjithë territorin ku shtrihet projekti, përkatësisht me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Bashkinë Kukës, ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te këto dy bashki.

Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5.

- germa “b” (leja e shfrytëzimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike).

Leja e përdorimit të burimit ujor nr. 353/10 prot., datë 18.9.2017, e përcjellë nga shoqëria, është e vlefshme deri më 4.9.2022. Duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, do t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitohet në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së saj, brenda datës 4.9.2022.

- Kontrata nr. 2856 rep., nr. 1350/1 kol., datë 22.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Qami 1’, me kapacitet 1.730 mw, në përroit të Srriqes, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqes, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës”, lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a. ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 45/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, ERE nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licençojë shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë për gjithë territorin ku shtrihet projekti, përkatësisht me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Bashkinë Kukës, ose çdo dokument tjetër që vërteton të drejtën e subjektit për të përdorur pronën në zonën e projektit që shtrihet te këto dy bashki.

3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor të rinovuar jo më vonë se afati i fundit i vlefshmërisë së saj, brenda datës 4.9.2022.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushteve, sipas përcaktimeve dhe afateve si më sipër.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti